Kronikë

Sekuestrohen 5 kallëpe tritol në Sarandë, 2 të montuara me telekomandë, arrestohen 2 vëllezër! Në kërkim një 26 vjeçar (EMRAT+VIDEO)

Dy vëllezër janë arrestuar nga policia e Sarandës pasi gjatë kontrollit të bërë në shtëinë e tyre u janë gjetur dhe sekuestruar 5 kallëpe tritoli (2 prej tyre të programuara për shpërthim në distancë), 7 kapsolla detonatore, 3 krehra dhe municion luftarak. Në pranga kanë rënë vëllezërit Haredin Ogiçi, 61 vjeç dhe Huso Ogiçi, 56 vjeç.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
18 Shkurt, 14:00 | **Përditesimi: 18 Shkurt, 14:56**

Share

SARANDË- Dy vëllezër janë arrestuar nga policia e Sarandës pasi gjatë kontrollit të bërë në shtëinë e tyre u janë gjetur dhe sekuestruar 5 kallëpe tritoli (2 prej tyre të programuara për shpërthim në distancë), 7 kapsolla detonatore, 3 krehra dhe municion luftarak. Në pranga kanë rënë vëllezërit Haredin Ogiçi, 61 vjeç dhe Huso Ogiçi, 56 vjeç, të dy banues në lagjen nr. 1, Sarandë, ndërsa është shpallur në kërkim 26 vjeçari K.Ç.

Dyshohet se këta persona, në bashkëpunim me njëri-tjetrin merreshin me përgatitjen e lëndëve eksplozive për t'i shitur më pas tek grupe kriminale.

Operacioni i koduar 'Knock Out 5' vjen pas ***operacionit*** të zhvilluar në Vlorë ditë më parë, ku u arrestua Gjergji Dervishaj pasi në objektin që kishte në pronësi të cilin e përdorte për shitjen e rrobave, u gjetën mina me telekomandë, armë kallashnikov dhe municion luftarak të cilat iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

LEXO EDHE:
Shkrumbohet nga flakët makina në Vlorë, ja çfarë raportohet (VIDEO)

Ndërkohë, në kuadër të operacionit të zhvilluar sot nga policia në Sarandë, ka nisur hetimi në gjendje të lirë për një 58 vjeçar, të cilit gjithashtu iu gjetën në banesë sasi municioni luftarak të cilat iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

B.V/Shqiptarja.com

TAG: Vlorë | Gjergji Dervishaj | eksplozivë | sarandë | Haredin Ogiçi | Huso Ogiçi

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Mendoni se Federata e Rithemelimit me partitë opozitare i dërgon në fitore?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Nga Gjermania, SHBA e Italia, djemtë emigrantë bëhen bashkë për të bërë rrugën në Vranisht
17 Shkurt, 17:15

Planifikuan vrasjen e Inez Hajrullës, goditet 'trekëndëshi' kriminal në Vlorë, arrestohet 35-vjeçari me tre identitete, në kërkim dy të tjerë (Emri)
17 Shkurt, 15:15

Vlorë/ Në kërkim për vjedhje, arrestohet 20-vjeçari! VIDEO nga momenti kur thyen derën e lokalit
17 Shkurt, 10:20

Auron Tare ngre alarmin: Çekiçët po gërmojnë pranë Sinagogës së shekullit të V-të në Sarandë! Në '97-ën Nano rrafshoi kioskat për ta mbrojtur
16 Shkurt, 20:40

Vlorë, shkrumbohet nga flakët fuoristrada teksa tërhiqte 'skafin' në rrugën e fshatit Kuç
16 Shkurt, 18:26

Gangrena e plehrave në Vlorë, në prill hapet landfilli i ri për depozitimin e mbetjeve urbane

Armand Xhelili

16 Shkurt, 16:03

Vlorë/ Përfshihen nga flakët kodrat në fshatin Kërkovë, banorët digjnin barishte dhe u doli nga kontrolli (VIDEO)
16 Shkurt, 13:02

VIDEO/Vlorë, i vodhi celularin shitëses së supermarketit, 29 vjeçari hajdut serial i pajisjeve dhe kabllove elektrike
15 Shkurt, 14:03

Iu gjetën 4 kallashnikovë dhe minë me telekomandë në dyqanin e rrobave në Vlorë, lihet në burg i riu me nofkën 'Zoto'
14 Shkurt, 16:43

I dënuar në Itali me 7 vite burg për trafik droge, arrestohet 39-vjeçari në Vlorë
13 Shkurt, 09:46

Blinin me euro të false nëpër dyqane në Vlorë, arrestohen 2 të rinj! Iu sekuestruan 2500 euro të falsifikuara, 120 mijë lekë, 1 automjet e 4 celularë
13 Shkurt, 08:39

Vlorë/ Zbulohet depo armësh në dyqanin e rrobave! Gjenden 4 kallashnikovë, minë me telekomandë e qindra fishekë! Arrestohet 'Zoto'
12 Shkurt, 12:53

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje